



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 4, datë 17.1.2023

PËR

**EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË AGJENCISË
SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 6, të nenit 14, të ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të pikës 7, të vendimit nr.109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit,

URDHËROJ:

1. Emërimin e znj. Xhiliola Bixheku drejtor i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.
2. Marrëdhëniet e punës në pozicionin e drejtorit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë fillojnë nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

NR.PROT. 134/1
DATË 26.1.2023

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË SË
ARSIMIT TË LARTË

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI

